EY
Building a batter
working world

Tel: +31 88 407 10 00
Fax: +31 88 407 10 05
ey.com

Ernst & Young Accountants LLP
Cross Towers, Antonio Vivaidistraat 150
1083 HP Amsterdam, Netherlands
Postbus 7883
1008 AB Amsterdam Netherlands

# Raport i Auditorit të pavarur

Drejtuar: Këshillit të Administrimit të Hewlett-Packard International Trade B.V.

Ne kemi rishikuar pasqyrat financiare të Hewlett-Packard International Trade B.V., Amstelveen, që përbëjnë bilancin më 31 tetor 2014, llogaria e fitimit dhe humbjes për vitin e përfunduar dhe shënimet, që përmban një përmbledhje të politikave kontabël dhe informacione të tjera shpjeguese.

## Përgjegjësia e Këshillit të Administrimit

Këshilli i Administrimit është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Pjesën 9 të Librit 2 të Kodit Civil holandez. Për më tepër, Këshilli i Administrimit është përgjegjës për kontrollin e brendshëm pasi konstaton se ai është i nevojshëm në mundësimin e përgatitjes së pasqyrave financiare pa anomali materiale të shkaktuara nga mashtrimet apo gabimet.

## Përgjegjësia e Auditorit

Përgjegjësia jonë është të shprehim një konkluzion lidhur me pasqyrat financiare. Ne kemi bërë rishikimin tonë në përputhje me ligjin holandez, duke përfshirë Standardin holandez 2400 *Angazhimet për Rishikimin e Pasqyrave Financiare*. Kjo kërkon që ne të zbatojmë kërkesat etike dhe të planifikojmë dhe kryejmë rishikimin për të qenë në gjendje të konstatojmë se kemi marrë dijeni të besueshme se pasqyrat financiare nuk janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar.

Një përmbledhje e pasqyrave financiare në përputhje me Standardin holandez 2400 është një angazhim i kufizuar i sigurimit. Procedurat e realizuara konsistuan kryesisht në kryerjen e kontrolleve të Këshillit të Administrimit dhe të të tjerëve brenda njësisë, sipas rastit, duke aplikuar procedura analitike dhe duke vlerësuar provat e marra. Procedurat e kryera në një shqyrtim janë dukshëm më pak se ato të kryera në një kontrolli të kryer në përputhje me Standardet holandeze të Auditimit. Prandaj, ne nuk shprehim një opinion auditimi.

## Përfundim

Bazuar në auditimin tonë, nuk kemi konstatuar asgjë që të na bëjë të besojmë se pasqyrat financiare nuk japin një pamje të vërtetë dhe të drejtë të pozitës financiare të Hewlett-Packard International Trade B.V. më 31 tetor 2014 dhe të rezultatit të saj për vitin e përfunduar në pajtim me Pjesën 9 të Librit 2 të Kodit Civil holandez.

Amsterdam, 30 prill, 2015

Ernst & Young Accountants LLP

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PËRKTHYESE ZYRTARE
ANILA MYFTARAJ
( BINAJ )
Cel : 0692671702
Nipt : L 11703001 M
OFFICIAL & SWORN TRANSLATOR

**HEWLETT- PACKARD INTERNATIONAL TRADE B.Y., AMSTELVEEN**

**Pasqyrat financiare për vitin e mbyllur 31 tetor 2014**

Sigluar
vetëm për qëllime identifikimi

Ernst & Young Accountants LLP

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PËRKTHYESE ZYRTARE
ANILA MYFTARAJ
( BINAJ )
Cel : 0692671702
Nipt : L 11703001
OFFICIAL & SWORN TRANSLATOR

# TABELA E LËNDËS

| | |
|---|---|
| **Raport i Këshillit të Administrimit** | 3 |
| **Pasqyrat Financiare** | |
| Bilanci | 6 |
| Pasqyra e Fitimit dhe Humbjeve | 8 |
| Shënime në Pasqyrat Financiare | 9 |
| **Të dhëna të tjera** | |
| Përvetësimi i rezultatit neto | 19 |
| Zyrat e degës | 19 |
| Numri total i faqeve në këtë raport: | 19 |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PËRKTHYESE ZYRTARE
ANILA MYFTARAJ
( BINAJ )
Cel : 0692671702
Nipt : L 11703001 M
OFFICIAL & SWORN TRANSLATOR

HEWLETT- PACKARD INTERNATIONAL TRADE
B.V.,
AMSTELVEEN

# RAPORTI I KËSHILLIT TË ADMINISTRIMIT

Raport i Administratorëve për vitin e mbyllur më 31 tetor 2014

Administratorët kanë kënaqësinë të paraqesin raportin, së bashku me raportin e auditimit të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 tetor 2014.

## 1. Të dhëna të përgjithshme

**Aktivitetet kryesore dhe rishikimi i zhvillimit të biznesit**

Shoqëria ofron shërbime informatike, printimi, zgjidhje imazhi dhe shërbime për ndërmarrjet kryesisht të mëdha shumëkombëshe dhe qeveritë në Evropën Lindore, Lindjen e Mesme dhe Afrikë.

**Struktura Ligjore**

Hewlett-Packard International Trade B.V., Startbaan 16, 1187 XR, the Amstelveen ("Shoqëria") u themelua më 24 dhjetor 1998 dhe është një degë tërësisht në pronësi të Hewlett-Packard B.V. Hagë, Holandë. Shoqëria e fundit prind është Hewlett-Packard Company, Palo Alto, California, USA.

## 2. Të dhëna financiare

**Rezultatet e Shoqërisë**

Xhiroja për vitin ishte 124,350K USD krahasuar me 124.936K USD të vitit paraardhës.
Marzhi bruto ka rënë me 1,973K USD e cila konvertohet në 4% rënie të marzhit bruto krahasuar me vitin financiar 2013 (VF2013 - 38% dhe VF2012 - 40%).

Shoqëria raportoi një humbje prej 4,502K USD krahasuar me humbjen prej 340K USD në vitin paraardhës.

## 3. Prespektiva e ardhshme

Shoqëria do të vazhdojë aktivitetet e saj në të njëjtin nivel në vitin 2015 si në vitin 2014. Shoqëria pret të operojë në kushte të qëndrueshme financiare. Ekzistojnë trazira sociale në rajone të caktuara, ku Shoqëria operon, por kjo nuk duhet të ndikojë në masë të madhe në xhiron e Shoqërisë.

## 4. Miratimi i Raportit Vjetor

Ju lutemi me përzemërsi të miratoni raportin vjetor për vitin e mbyllur më 31 tetor 2014 (VF14).

## 4. Shpërndarja e fitimit/humbjes

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PËRKTHYESE ZYRTARE
ANILA MYFTARAJ
( BINAJ )
Cel : 0692671702
Nipt : L 11703001 M
OFFICIAL & SWORN TRANSLATOR

Ne propozojmë të reduktoni rezultatin neto 2014 nga deficiti i akumuluar.

## 5. Shpërndarja e balancuar e vendeve/mandateve

Shoqëria ka një administratore femër dhe si e tillë ka arritur një shpërndarje të balancuar të vendeve/mandateve.

Shoqëria synon të vazhdojë të ketë një shpërndarje të balancuar të vendeve/mandateve në të ardhmen.

**Këshilli i Administrimit**

Dao-Lai, Thi Kim Phuong    Rastbichler, Herbert Josef    Timmer, Coen

/nënshkrimet përkatëse/

15 prill 2015

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PËRKTHYESE ZYRTARE
ANILA MYFTARAJ
( BINAJ )
Cel : 0692671702
Nipt : L 11703001 M
OFFICIAL & SWORN TRANSLATOR

HEWLETT- PACKARD INTERNATIONAL TRADE
B.V.,
AMSTELVEEN

# PASQYRAT FINANCIARE

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PËRKTHYESE ZYRTARE
ANILA MYFTARAJ
( BINAJ )
Cel : 0692671702
Nipt : L 11703001 M
OFFICIAL & SWORN TRANSLATOR

HEWLETT- PACKARD INTERNATIONAL TRADE
B.V.,
AMSTELVEEN

**BILANCI**
**31 tetor 2014**
Pas përvetësimit të rezultatit neto

AKTIVET

| | Shënime | 2014 | | 2013 | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | USD'000 | USD'000 | USD'000 | USD'000 |
| **Aktive Afatgjata** | | | | | |
| Aktive afatgjata material | 3 | 2,382 | | 3,977 | |
| Totali i aktiveve afatgjata | | | 2,382 | | 3,977 |
| **Aktive Afatshkurtra** | | | | | |
| Inventari | | 2,161 | | 2,227 | |
| Të arkëtueshmet tregtare | | 28,971 | | 45,361 | |
| Të arkëtueshme të pafaturuara | | 10,296 | | 11,421 | |
| Kosto të drejtpërdrejta të shtyra të kontratës | | 661 | | 2,838 | |
| Të pagueshme nga filialet | | 4,883 | | 7,711 | |
| Të arkëtueshme tatimore | | 126 | | 216 | |
| Aktive të tjera afatshkurtra si dhe shpenzime të parapaguara | | 4,410 | | 5,224 | |
| Paraja dhe ekuialentët e saj | | 15,830 | | 20,326 | |
| Totali i aktiveve afatshkurtra | | | 67,338 | | 95,324 |
| **Totali i aktiveve** | | | **69,720** | | **99,301** |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PËRKTHYESE ZYRTARE
ANILA MYFTARAJ
( BINAJ )
Cel : 0692671702
Nipt : L 11703001
OFFICIAL & SWORN TRANSLATOR

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PËRKTHYESE ZYRTARE
ANILA MYFTARAJ
( BINAJ )
Cel : 0692671702
Nipt : L 11703001 M
OFFICIAL & SWORN TRANSLATOR

## Kapitali i Aksionarit dhe Detyrimet

| | Shënime | 2014 | | 2013 | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | USD'000 | USD'000 | USD'OOO | USD'OOO |
| **Kapitali i Aksionarit** | | | | | |
| Kapitali Aksionar | | 22 | | 22 | |
| Rezerva e Konvertimit | | (1) | | (1) | |
| Deficiti i Akumuluar | | (17,897) | | (13,395) | |
| **Kapitali total i aksionarit** | 6 | | (17,876) | | (13,374) |
| **Dispozitat** | 7 | | 1,315 | | 11,449 |
| **Detyrimet Afatgjata** | | | | | |
| Të ardhurat e shtyra - Afatgjatë | | 4,259 | | 2,538 | |
| Përfitimet nga ndërprerja e marrëdhënieve të punës | | 10,456 | | 8,906 | |
| Totali Detyrime Afatgjata | | | 14,715 | | 11,444 |
| **Detyrime Afatshkurtra** | | | | | |
| Llogaritë e pagueshme | | 4,895 | | 12,017 | |
| Të pagueshme për filialet | | 9,473 | | 10,169 | |
| Hua nga filialet | | 17,005 | | 31,112 | |
| Të pagueshme tatimore | | 5,055 | | 884 | |
| Të ardhura të shtyra - Afatshkurtra | | 18,310 | | 19,717 | |
| Detyrime Akruale dhe të pagueshme të tjera | 8 | 16,828 | | 15,883 | |
| Totali Detyrime Afatshkurtra | | | 71,566 | | 89,782 |
| **Total Kapitali i Aksionerit dhe Detyrime** | | | **69,720** | | **99,301** |

*Shënimet shoqëruese janë pjesë përbërëse e këtyre llogarive vjetore.*

## LLOGARIA E FITIM/HUMBJEVE
**Për vitin e mbyllur 31 tetor 2014**

| | Shënime | 2014 | | 2013 | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | USD’000 | USD’000 | USD’000 | USD’000 |
| Xhiro Neto | 11 | 124,350 | | 124,936 | |
| Kosto e shitjeve | | 76,881 | | 75,494 | |
| **Fitim Bruto** | | | 47,469 | | 49,442 |
| Shpenzime Shitjeje | | 40,923 | | 38,721 | |
| Shpenzime të përgjithshme dhe administrative | 12 | 6,597 | | 5,868 | |
| **Shpenzime totale** | | | 47,520 | | 44,589 |
| **Të ardhura operative** | | | (51) | | 4,853 |
| Shpenzime financiare, neto | 13 | | 3,233 | | 832 |
| **Fitim nga aktivitetet e zakonshme para tatimit** | | | (3,284) | | 4,021 |
| Tatimi mbi Fitimin nga aktivitete të zakonshme | | | | | |
| Viti aktual | 14 | | (3,726) | | 3,068 |
| Viti i mëparshëm | 14 | | 4,944 | | 1,293 |
| Humbje neto | | | **(4,502)** | | **(340)** |

*Shënimet shoqëruese janë pjesë përbërëse e këtyre llogarive vjetore.*

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PËRKTHYESE ZYRTARE
ANILA MYFTARAJ
( BINAJ )
Cel : 0692671702
Nipt : L 11703001
OFFICIAL & SWORN TRANSLATOR

**SHËNIME TË PASQYRAVE FINANCIARE**
**31 tetor 2014**

## 1. Të përgjithshme

Hewlett-Packard International Trade B.V., Startbaan 16, 1187 XR, Amstelveen ("Shoqëria") u themelua më 24 dhjetor 1998 dhe është një nëndegë tërësisht në pronësi të Hewlett-Packard The Hague B.V., Hollandë. Shoqëria e fundit prind është Hewlett-Packard Company, Palo Alto, California, USA. Shoqëria ofron shërbime informatike, printimi, zgjidhje imazhi dhe shërbime për ndërmarrjet kryesisht të mëdha shumëkombëshe dhe qeveritë në Evropën Lindore, Lindjen e Mesme dhe Afrikë.

**Deklarata e detyrimeve të përbashkëta dhe individuale**

Hewlett-Packard The Hague B.V. deklaron, në përputhje me nenin 403, paragrafi 1 sub 4 Libri 2 I Kodit Civil holandez, se është bashkërisht dhe individualisht përgjegjëse për borxhet, që rrjedhin nga akte ligjore të shoqërisë. Pasqyrat financiare të Shoqërisë janë përfshirë në pasqyrat financiare të konsoliduara të Hewlett-Packard e B.V. Hague të cilat janë dorëzuar në Dhomën e Tregtisë në Amsterdam.

**Deklarata e Miratimit**

Hewlett-Packard The Hague B.V. deklaron, në përputhje me nenin 403, paragrafi 1 sub 4 Libri 2 I Kodit Civil holandez, se jep pëlqimin në devijim nga rregullat e titullit 9 të Librit 2 të Kodit Civil holandez.

## 2. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël

**Të përgjithshme**

Pasqyrat financiare janë përgatitur në bazë të supozimit të vijimësisë (shënimi 17), konventën e kostos historike,në përputhje me Pjesën 9 të Librit 2 të Kodit Civil holandez dhe parimet e kontabilitetit përgjithësisht të pranuara në Holandë. Parimet e kontabilitetit janë zbatuar në mënyrë konsistente gjatë gjithë vitit dhe vitit të mëparshëm.

**Konvertimi i monedhave të huaja**

Shoqëria përdor dollarin amerikan si monedhën e saj funksionale. Aktivet dhe detyrimet në valutë të huaj janë konvertuar. Aktivet dhe detyrimet në valutë të huaj janë konvertuar në dollarë në fund të periudhës së kursit të këmbimit, me përjashtim të aktiveve jo-monetare dhe detyrimeve të tilla si inventarët, aktivet afatgjata dhe të ardhurat e shtyra, të cilat konvertohen në normat historike të këmbimit. Xhiroja neto dhe shpenzimet konvertohen në normat mesatare të kursit të këmbimit në fuqi gjatë çdo periudhe.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PËRKTHYESE ZYRTARE
ANILA MYFTARAJ
(BINAJ)
OFFICIAL & SWORN TRANSLATOR

me përjashtim të atyre shpenzimeve që lidhen me shumat jo-monetare të bilancit, të cilat janë konvertuar në normat historike të këmbimit. Fitimet ose humbjet nga konvertimi i valutës së huaj janë përfshira në llogarinë e fitimit dhe humbjes.

Në pajtim me nenin 362 nën 7 të Librit 2 të Kodit Civil holandez, të gjitha shumat në shënimet e pasqyrave financiare shprehen në dollarë, nëse nuk shprehet ndryshe.

**Kompensimi**

Aktivet dhe detyrimet kompensohen vetëm në pasqyrat financiare nëse dhe deri në masën që:

- ekziston një e drejtë zbatueshme ligjore për të kompensuar aktivet dhe detyrimet dhe për shlyerjen e tyre në të njëjtën kohë; dhe
- qëllimi pozitiv është shlyerja e aktiveve dhe detyrimeve mbi një bazë neto, ose në të njëjtën kohë.

**Aktivet Afatgjata Materiale**

Aktivet Afatgjata materiale në përdorim nga Shoqëria mbarten me koston e blerjes neto nga zhvlerësimi i akumuluar dhe humbjet e akumuluara nga zhvlerësimi. Zhvlerësimi llogaritet duke përdorur metodën lineare gjatë jetës së dobishme të aktiveve, si më poshtë: mobilje zyre, përmirësime zyre dhe pajisje - 2 deri në 5 vjet.

**Inventari**

Inventari paraqitet me koston më të ulët (metoda mesatare e ponderuar) dhe vlerën neto të realizueshme dhe përbëhet kryesisht nga pjesët e këmbimit.

**Të arkëtueshmet tregtare**

Të arkëtueshmet tregtare paraqiten neto nga provigjoni për borxhet e dyshimta.

**Kosto të drejtpërdrejta të shtyra të kontratës**

Kosto të drejtpërdrejta të shtyra të kontratës janë kostot e drejtpërdrejta të projektit që shkaktohen në kontratat tregtare. Njohja e këtyre shpenzimeve shtyhet deri në pranimin e tyre nga klienti.

**Aktive të tjera afatshkurtra si dhe shpenzime të parapaguara**

Aktive të tjera afatshkurtra si dhe shpenzime të parapaguara janë aktive me datën e shlyerjes brenda një viti dhe të cilat përfshijnë shpenzimet e parapaguara të qirasë dhe dietat e punonjësve.

**Tatimi**

Tatimi i shtyrë del duke përdorur metodën e detyrimeve, për të gjitha diferencat në kohë ndërmjet tatimit dhe raportimit financiar, kryesisht në lidhje me amortizimin. Aktivet tatimore të shtyra që krijohen nga mbartjet e humbjeve tatimore njihen vetëm në qoftë se ka siguri për rimëkëmbje të arësyeshme. Duke filluar nga 1 nëntor 2004, shoqëria ka formuar një njësi fiskale me shoqërinë e saj prind dhe palë të tjera të lidhura brenda grupit të shoqërive Hewlett-Packard The Hague.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PËRKTHYESE ZYRTARE
ANILA MYFTARAJ
( BINAJ )
Cel : 0692671702
Nipt : L 11703001 M
OFFICIAL & SWORN TRANSLATOR

**Përfitimet nga ndërprerja e marrëdhënieve të punës**

Është krijuar provigjon për shumat e pagueshme sipas ligjit të punës së Arabisë Saudite në fuqi për periudha të akumuluara shërbimi të punonjësve në datën e bilancit.

**Të ardhurat e shtyra**

Të ardhurat e shtyra lidhen me kontratat e mbështetjes / mirëmbajtjes me cmime fikse dhe me kontrata ë konsulencës ku të ardhurat nuk njihen ende.

**Të tjera aktive dhe detyrime**

Të gjitha aktivet dhe detyrimet e tjera paraqiten me shumat në të cilat ata janë fituar apo realizuar.

**Të ardhurat dhe shpenzimet**

Të ardhurat njihen kur ekzistojnë prova bindëse për marrëveshje shitjeje, kur shërbimi është ofruar apo kryer, çmimi i shitjes është fiksuar ose është i përcaktueshëm dhe kur arkëtimi sigurohet në mënyrë të arsyeshme.

Të ardhurat nga shitjet e produktit njihen përgjithësisht, kur titulli dhe rreziku i transferimit të humbjes te klienti, në përgjithësi në kohën kur produkti i dorëzohet klientit, me dispozita të përcaktuara për kthimet e vlerësuara të produktit. Të ardhurat e shërbimit njihen gjatë periudhës së kontratës ose pasi shërbimet kryhen dhe pranohen nga klienti.

Të ardhurat e tjera, kostot dhe shpenzimet ndahen për vitin me të cilin ato lidhen. Humbjet llogariten në vitin në të cilin ata identifikohen.

**Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare**

Në përputhje me Udhëzimet për Raportimin Vjetor në Holandë, Shoqëria përjashtohet nga përfshirja e pasqyrës së fluksit të mjeteve monetare në pasqyrat e saj financiare. Të dhënat e fluksit të mjeteve monetare të shoqërisë përfshihen në pasqyrën e fluksit të mjeteve monetare të paraqitur në pasqyrat financiare të konsoliduara të shoqërisë së fundit prind të Hewlett-Packard Company, Palo Alto, SHBA, për vitin e mbyllur 31 tetor 2014, dorëzuar në Dhomën e Tregtisë në Amsterdam.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PËRKTHYESE ZYRTARE
ANILA MYFTARAJ
( BINAJ )
Cel : 0692671702
Nipt : L 11703001 M
OFFICIAL & SWORN TRANSLATOR

## 3.Aktivet afatgjata materiale

| | 2014 | 2013 |
|---|---|---|
| | USD'000 | USD'000 |
| Pajisje Zyre | 471 | 760 |
| Makineri dhe Pajisje | 1,911 | 3,217 |
| | 2,382 | 3,977 |

Lëvizjet gjatë vitit janë si në vijim:

| | Pajisje zyre | Makineri dhe Pajisje | **Total** |
|---|---|---|---|
| | USD '000 | USD '000 | USD '000 |
| Vlera neto kontabël më 1 nëntor 2013 | 760 | 3,217 | 3,977 |
| Shtesa | 226 | 519 | 745 |
| Depozitime | (252) | (326) | (578) |
| Zhvlerësim | (263) | (1,499) | (1,762) |
| Vlera neto kontabël më 31 tetor 2014 | 471 | 1,911 | 2,382 |
| Zhvlerësimi i akumuluar më 31 tetor 2014 | 2,229 | 5,108 | 7.367 |

## 4. Aktive të tjera afatshkurtra dhe shpenzime të parapaguara

| | **2014** | **2013** |
|---|---|---|
| | USD'000 | USD'000 |
| Shpenzime të parapaguara | 3,476 | 4,823 |
| Tatime të parapaguara | 380 | 388 |
| Paradhënie të paguara | 8 | 7 |
| Aktive të tjera afatshkurtra | 546 | 6 |
| | 4,410 | 5,224 |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PËRKTHYESE ZYRTARE
ANILA MYFTARAJ
( BINAJ )
Cel : 0692671702
Nipt : L 11703001 M
OFFICIAL & SWORN TRANSLATOR

## 5. Paraja dhe Ekuivalentët e saj

| | 2014 | 2013 |
|---|---|---|
| | USD'000 | USD'000 |
| Para në dorë | | 19 |
| Para në Bankë | 15.830 | 20,307 |
| | 15.830 | 20,326 |

Të gjitha balancat bankare dhe paratë në dorë janë në dispozicion të lirë të shoqërisë.

## 6. Kapitali i aksionarit

| | Kapitali Aksionar | Rezerva e Konvertimit | Deficiti i Akumuluar | **Totali** |
|---|---|---|---|---|
| | USD'000 | USD'000 | USD'000 | USD'000 |
| Gjendja më 1 nëntor 2013 | 22 | (1) | (13,395) | (13,374) |
| Humbja neto për vitin | | | (4,502) | (4,502) |
| Gjendja më 31 tetor 2014 | 22 | 0) | (17,897) | (17,876) |

Aksionet e emetuara janë paguar plotësisht në para të gatshme. Kapitali i emetuar aksionar më 31 tetor, 2014 përbëhet nga 40 aksione prej 453,78 € secila, të cilat janë paguar plotësisht. Për të arritur vlerën e dollarit të kapitalit aksionar, kursi i këmbimit i përdorur ishte 1,263.

## 7. Provigjonet

| | 2014 | 2013 |
|---|---|---|
| | USD'000 | USD'000 |
| Provigjone | 1,315 | 11,449 |
| | 1,315 | 1 1,449 |

Lëvizjet gjatë vitit janë si në vijim:

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PËRKTHYESE ZYRTARE
ANILA MYFTARAJ
( BINAJ )
Cel : 0692671702
Nipt : L 11703001 M
OFFICIAL & SWORN TRANSLATOR

| | Total |
|---|---|
| | USD '000 |
| Vlera neto kontabël më 1 nëntor 2013 | 11,449 |
| Shtesat | |
| Përdorimi | (3,133) |
| Të pagueshme | (7,001) |
| Vlera neto kontabël më 31 tetor 2014 | 1,315 |

Provigjoni tatimor i krijuar në librat e Shoqërisë mbulon ekspozimin e përhershëm tatimor dhënë në vendet si Oman, Katar dhe Kuvajt në rajonin e Lindjes së Mesme.

Ju lutemi t'i referoheni shënimit 14 për detaje të mëtejshme.

## 8. Detyrimet akruale dhe të pagueshme të tjera

| | 2014 | 2013 |
|---|---|---|
| | USD'000 | USD'000 |
| Shpenzime akruale ( të përllogaritura) | 10,630 | 10,536 |
| Kompensim akrual i punonjësve | 6,106 | 5,274 |
| Kontribute të sig.shoqërore dhe të tjera | 91 | 73 |
| | 16,827 | 15,883 |

## 9. Angazhimet dhe Detyrimet e Paparashikuara

Nuk ka zotime për shpenzime kapitale në 31 tetor, 2014. Shoqëria ka dhënë garanci (bankare) si siguri deri në një shumë prej 312m USD (2013: USD 859K) më 31 tetor 2014.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PËRKTHYESE ZYRTARE
ANILA MYFTARAJ
( BINAJ )
Cel : 0692671702
Nipt : L 11703001 M
OFFICIAL & SWORN TRANSLATOR

## 10. Menaxhimi i riskut

### Risqe të Kreditit

Sghoqëria nuk ka risqe të mëdha krediti, përveç atyre që tashmë janë parashikuar, as përqëndrime krediti me një klient të vetëm ose në një rajon të industrisë apo gjeografik i cili mbart një rrezik jashtëzakonisht të lartë të kredisë.

**Risqet e interesit**

Shoqëria nuk mban asnjë risk të rëndësishëm interesi.

**Vlerat e Drejta**

Sipas natyrës së tyre afatshkurtër, vlerat e drejta të aktiveve dhe detyrimeve financiare të përfshira në debitorët dhe detyrimet afatshkurtra përafërsojnë shumat e tyre kontabël.

## 11. Xhiroja Neto

Përbërja gjeografike e xhiros neto ishte:

| | 2014 | 2013 |
|---|---|---|
| | USD'000 | USD'000 |
| Lindje e Mesme | 98,758 | 101,826 |
| Europa Lindore | 15,648 | 15,862 |
| Afrikë | 9,944 | 7,248 |
| | 124,350 | 124,936 |

Rritja në të Ardhurat në VF 2013 është kontribuar kryesisht nga rajoni i Lindjes së Mesme.

## 12. Shpenzime të përgjithshme dhe administrative

| | 2014 | 2013 |
|---|---|---|
| | USD'000 | USD'000 |
| Zhvlerësimi i aktiveve afatgjata materiale | 1,762 | 1,617 |
| Shpenzime të tjera të përgjithshme dhe administrative | 4,835 | 4,251 |
| | 6,597 | 5,868 |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PËRKTHYESE ZYRTARE
ANILA MYFTARAJ
( BINAJ )
Cel : 0692671702
Nipt : L 11703001M
OFFICIAL & SWORN TRANSLATOR

**Tarifat e auditimit dhe të gjitha tarifat e tjera**
Tabela e mëposhtme tregon tarifat e përllogaritura në lidhje me shërbimet e ofruara nga Auditorët e Ernst & Young LLP, Holandë, për vitet financiare 2014 dhe 2013.

| | **2014** | **2013** |
|---|---|---|
| | USD'000 | USD'000 |
| Tarifat e auditimit | 17 | 17 |
| | 17 | 17 |

## 13. Shpenzime Financiare Neto

| | **2014** | **2013** |
|---|---|---|
| | USD'000 | USD'000 |
| Shpenzime interesi dhe shpenzime të tjera Të | 4,543 | 2,567 |
| Të ardhura interesi dhe të ardhura të tjera financiare | (1,310) | (L735) |
| | 3,233 | 832 |

## 14. Tatimi mbi fitimin mbi aktivitete të zakonshme

| | **2014** | **2013** |
|---|---|---|
| | USD'000 | USD'000 |
| Tatim i tarifuar për P&L | 1,218 | 4,361 |
| | 1,218 | 4,361 |

| | **2014** | **2013** |
|---|---|---|
| | USD'000 | USD'000 |
| Fitimi para tatimit vetëm i juridiksionit përkatës tatimor | 14,993 | 17,666 |
| Shpenzime tatimore | 1,218 | 4,361 |
| Norma Tatimore Efektive | 8% | 25% |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PËRKTHYESE ZYRTARE
ANILA MYFTARAJ
( BINAJ )
Cel : 0692671702
Nipt : L11703001
OFFICIAL & SWORN TRANSLATOR

Shoqëria kryen aktivitetet e saj të biznesit në disa juridiksione tatimore. Përqindjet tatimore nominale variojnë nga 0% në 35% në varësi të juridiksionit tatimor. Norma tatimore efektive ndikohet nga fitimet e njohura për qëllime tatimore dhe shpenzimet jo të zbritshme. Norma efektive tatimore e shoqërisë mund të luhatet ndërmjet viteve në varësi të afatit të projekteve në juridiksione të ndryshme tatimore.

Norma tatimore efektive llogaritet në bazë të të ardhurave të tatueshme në VF14 të juridiksionit përkatës tatimor.

Humbjet tatimore ekzistojnë në juridiksione të caktuara të cilat nuk njihen duke qenë se shfrytëzimi i tyre brenda periudhës përkatës të mbartur nuk sigurohet përtej dyshimit të arsyeshëm. Devijimet midis normës efektive të tatimit mbi fitimin dhe normës së tatimit mbi të ardhurat ligjore kanë të bëjnë me ndryshimet në normat tatimore në juridiksione të ndryshme dhe toleranca vlerësimi mbi aktivet tatimore të shtyra.

## 15. Transaksione të palëve të lidhura

Shoqëria blen në thelb të gjithë mallrat dhe shërbimet (të përfshira në koston e shitjes) nga palët e lidhura brenda grupit Hewlett-Packard.

Shoqëria ka një marrëveshje "*cash pool*" me një filial të Hewlett-Packard. Shoqëria pranon ose paguan interes në varësi të pozicionit që mban në "*cash pool*".

Politika e Shoqërisë është që transaksionet me palët e lidhura lidhen mbi kushte jo më pak të favorshme se ato që do të ekzistonin nëse këto transaksione do të lidheshin jo me palë të treta në baza të barabarta.

## 16. Të dhëna të punonjësit

| | 2014 | 2013 |
|---|---|---|
| | USD'000 | USD'000 |
| Rrogat dhe pagat | 51,273 | 48,652 |
| Kosto të sigurimeve shoqërore | 4,641 | 3,950 |
| | 55,914 | 52,602 |

Numri i përgjithshëm i punonjësve të punësuar nga Shoqëria është 462 (2013: 469).

REPUBLIKA E SHQIPËRISË PËRKTHYESE ZYRTARE ANILA MYFTARAJ (BINAJ) Cel: 0692671712 Nipt: L 11703001I OFFICIAL & SWORN TRANSLATOR

## 17. Baza të vijimësisë

Shoqëria ka përdorur " supozimin e vijimësisë " në përgatitjen e pasqyrave financiare më 31 tetor 2014. Supozimi i vijimësisë është zbatuar në bazë të konfirmimit nga aksionari i shoqërisë, Hewlett-Packard BV Hagë, që ka qëllim të sigurojë fonde të mjaftueshme për Shoqërinë për shlyerjen e borxheve dhe detyrimeve të saj, si dhe kur janë të pagueshme të paktën 12 muaj nga data e këtyre pasqyrave financiare.

## 18. Shifrat krahasuese

Shifra të caktuara krahasuese janë riklasifikuar për të qenë në përputhje me paraqitjen e vitit aktual.

### 19. Ngjarjet gjatë vitit

Më 6 tetor 2014, Hewlett-Packard (HP) njoftoi planet për ndarjen në dy shoqëri të pavarura të tregtuara publikisht: njëra ka të bëjë me infrastrukturën e teknologjisë së ndërmarrjes, softëare, shërbimet dhe bizneset e financimit, e cila do të kryejë aktivitetin si Hewlett-Packard Enterprise dhe do të përfshijë aktivitetet të printimit dhe sistemeve personale, të cilat do të kryejnë aktivitet si HP Inc. Ndarja është subjekt i kushteve të caktuara, duke përfshirë, ndër të tjera, marrjen e miratimit përfundimtar nga Këshilli i Administrimit të HP-së. Ndarja pritet të përfundojë deri në fund të vitit fiskal 2015. Sipas planit të ndarjes, aksionerët HP do të zotërojnë aksionet të Hewlett-Packard Enterprise dhe HP Inc. Këshilli i Administrimit është aktualisht duke vlerësuar ndikimin e ndarjes së tillë mbi pasqyrat financiare të Shoqërisë.

## 19. Shpërblimi i Administratoreve

Në vitin 2014 dhe 2013 nuk u pagua shpërblim për Administratorët.

**Këshilli i Administrimit**

Dao-Lai, Thi Kim Phuong    Rastbichler, Herbert Josef    Timmer, Coen

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PËRKTHYESE ZYRTARE
ANILA MYFTARAJ
( BINAJ )
Cel : 0692671702
NIPT : L11701001 M
OFFICIAL SWORN TRANSLATOR

# Të dhëna të tjera

## Opinioni i Auditimit

Hewlett-Packard The Hague B.V. deklaron, në përputhje me nenin 403 paragrafi 1 nën 4 Libri 2 i Kodit Civil Holandez, se është bashkërisht dhe individualisht përgjegjës për borxhet, që rrjedhin nga akte ligjore të shoqërisë. Pasqyrat financiare të Shoqërisë janë përfshirë në pasqyrat financiare të konsoliduara të Hewlett-Packard e B.V. Hague, të cilat janë dorëzuar në Dhomën e Tregtisë në Amsterdam. Rrjedhimisht, auditimi ikëtyre pasqyrave financiare nuk kërkohet me ligj dhe për këtë arsye nuk kryhet.

## Përvetësimi i rezultatit neto

Sipas nenit 15 të statutit të Shoqërisë, asambleja vjetore e aksionarëve përcakton ndarjen e fitimit neto të shoqërisë për vitin.

Administratoret propozojnë që fitimi neto i vitit 2014 rezultati të reduktohet nga fitimet e pashpërndara. Ky propozim është përfshirë në pasqyrat financiare.

## Zyrat e degës

| Emri Tregtar | Vendi, Shteti |
|---|---|
| • Hewlett Packard International Trade | |
| • Hewlett Packard International Trade | Almaty, Kazakistan Riyadh, |
| • Hewlett Packard International Trade | Arabia Saudite Kiev, Ukrainq |
| • Hewlett Packard International Trade | Shkup, Republika e Maqedonisë |
| • Hewlett Packard International Trade | Beirut, Liban |
| • Hewlett Packard International Trade | Baku, Azerbaxhan |
| • Hewlett Packard International Trade | Tiranë, Shqipëri |
| • Hewlett Packard International Trade | Pieta, Maltë |
| • Hewlett Packard International Trade | Muscat, Oman |
| • Hewlett Packard International Trade | Tripoli, Libi (CF) |
| • Hewlett Packard International Trade | Tripoli, Libi (CTS) |

## Ngjarjet e mëvonshme

Shoqëria ka në plan të mbyllë degët në vijim në vitin financiar 2015

- Hewlett Packard International Trade Kiev, Ukrainë

Shoqëria ka mbyllur këto degë në vitin financiar 2015:

- Hewlett Packard International Trade Almaty, Kazakistan

REPUBLIKA E SHQIPËRISË PËRKTHYESE ZYRTARE ANILA MYFTARAJ (BINAJ) Cel : 0692671702 Nipt : L 11703001 M OFFICIAL & SWORN TRANSLATOR

EY
Building a better working world

Ernst & Young Accountants LLP
Cross Towers, Antonio Vivaldistraat 150
1083 HP Amsterdam, Netherlands
Postbus 7883
1008 AB Amsterdam, Netherlands

Tel: +31 88 407 10 00
Fax: +31 88 407 10 05
ey.com

# Independent accountant's review report

To: the management board of Hewlett-Packard International Trade B.V.

We have reviewed the accompanying financial statements of Hewlett-Packard International Trade B.V., Amstelveen, that comprise the balance sheet as at October 31, 2014, the profit and loss account for the year then ended and the notes, comprising a summary of the accounting policies and other explanatory information.

## Management's responsibility

Management is responsible for the preparation and fair presentation of these financial statements in accordance with Part 9 of Book 2 of the Dutch Civil Code. Furthermore, management is responsible for such internal control as it determines is necessary to enable the preparation of the financial statements that are free from material misstatement, whether due to fraud or error.

## Accountant's responsibility

